



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1064

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Aritech", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF” me numër të prokurimit 98400-23-13505-5-5-8, me 20/03/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Aritech” me nr. 2023/1064, e datës 29/12/2023, kurse vendimi i AK Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit “Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF” me numër të prokurimit 98400-23-13505-5-5-8, mbetet në fuqi.

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.10.2023 Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF” me numër të prokurimit 98400-23-13505-5-5-8.

Me datën 11.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “NMA” Sh.P.K.

Me 19.12.2023 OE “Aritech” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Aritech” me nr. 1064/23 për aktivitetin “Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF” me numër të prokurimit 98400-23-13505-5-5-8.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigje AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE “Aritech”

“Përgjigje lidhur me pretendimet ankimore: Ne si Autoriteti kontraktues, kemi shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në kërkesë për rishqyrtim. Konsiderojmë se asnjë nga pretendimet ankimore nuk qëndron. Bazuar në kërkesën luaj lidhur me katalog ne dosje te tenderit nuk është kërkuar as katalogu as kriteret tjera katalogu ofrohet te AQP fillim te nënshkrimit te kontratave. Qasje ju është lejuar sipas nenit 1 të LPP-ës. si informata sekrete afariste te cilat janë kërkuar nga OE, që të klasifikohen nga AK vetëm dokumentet qe nuk janë sekret afarist”

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Aritech” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se: “Ne me date 14.12.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ne njoftimin mbi vendimin AK ka vendosur te shpërblejë me kontrate OE Tech Vision SH.P.K. Ne kemi kërkuar qasje ne dokumentet e dorëzuara për dy OE pjesëmarrës me te lire sipas çmimit te ofruar. Autoriteti Kontraktues na ka mundësi qasje ne dokumentet e dorëzuara, por jo ne te gjitha dokumentet te dorëzuara, pra ne kundërshtim me LPP na ka ofruar qasje te pjesshme. Autoriteti juaj na ka dorëzuar ne mënyrë fizike dokumentet ne vijim te OE Tech Vision dhe Cactus: Përshkrimi i çmimeve, deklarata mbi përshtatshmërinë dhe deklarata nen betim. Te gjitha këto janë te shënuara ne procesverbal nga takimi (bashkangjitur). Autoriteti Kontraktues me këtë veprim nuk ka respektuar Nenin 10 pika 1, pika 2 dhe pika 3 duke mos dorëzuar te gjitha dokumentet e kërkuara. Nuk është siguruar qasje për te gjitha dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomik!. Ne baze te kësaj ne konsiderojmë qe oferta e OE-ve nuk ka qene e plote 5/8. Nga Autoriteti Kontraktues na është thënë qe nuk ka dokumente tjera, por pa na ofruar dokumentin “Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse” qe dëshmon dokumentet e dorëzuara nga OE, nder to do duhej te ishte edhe kërkesa për sekret afarist. Vlerësojmë qe ofertat e dorëzuara nga OE-te për te cilat kemi kërkuar qasje ne dokumente, duke mos dorëzuar broshura fare dhe duke mos specifikuar as oferte teknike

as brend te ofruar është e papërgjegjshme dhe duhet te eliminohet. Lidhur me mosdorëzim te broshurave për produktet tanimë kemi se paku dy vendime nga OSHP, Vendimi nr: 214/22 dhe Vendimi nr: 482/23. Autoriteti Kontraktues e zhvillon këtë aktivitet te prokurimit ne kuadër te kontratës kornize te AQP-se, prandaj baza është e qarte. Ne vijim gjeni printscreen lidhur me specifikimin teknik nga kontrata ne mes te AQP-se dhe OE".

Pretendimi i dytë (II), Ankuesi pretendon se: "Përfundim Citati. Ne në baze te atyre qe kemi cekur me lart, OE-te për te cilat kemi kërkuar qasje ne dokumente nuk kane dorëzuar specifikim teknik, broshura, brand, model te produkteve te kërkuara. Prandaj mos dorëzimi i specifikimit teknik pamundëson vlerësimin e drejt për te gjithë OE-te. Duke u bazuar ne te gjitha këto me lart, ne do te bashkëngjisim vendimet e OSHP-se lidhur me mosdorëzim te specifikimit teknik, procedure e zhvilluar ne kuadër te AQP-se. Pra, kemi te bëjmë përsëri me te njëjtën kontrate kornize, e cila është vazhduar, prandaj konsiderojmë qe është koncept i njëjtë. Vendimet e OSHP-se janë pikërisht për një kontrate e cila është zhvilluar dhe zhvillohet ne kuadër te AQP-se. Pasiqe lënda e Ankesës është e njëjtë, procedura e prokurimit është e njëjtë, zhvillohet ne kuadër te kontratës kornize me AQP-ne, poashtu kemi vendime te OSHP-se (214/22, 482/23) prandaj kërkojmë nga Organi juaj shqyrtues te merr vendim duke u bazuar ne argumentet e lartcekura".

-Administrimi i provave-

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1064/23, ndërsa me datë 12.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1064 me rekomandimet si në vijim: *"Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim"*.

Lidhur me pretendimet e OE "Artiech." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0164 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): "Pretendimet kryesor te OE ankues kanë sipas ankesës nr.22/23 janë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, ku sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar fare specifikacionin Teknik, me emrin e prodhuesi dhe emrin e modelit me të cilin ka ofertuar, kërkesa këto të ftesës për ofertim si dhe kontratës kornizë të AQP-së me nr. UA/2016-23-5755-1-1-1. Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nuk kemi gjetur se i njëjti ka ofruar specifikacion Teknik, të dhënat e prodhuesit dhe modelit që ofrohet ashtu si është kërkuar në dosje të tenderit si dhe përmes dosjes së tenderit të kontratës kornizë të AQP-së me nr. UA/2016-23-5755-1-1-1. Po ashtu vlerësojmë se është i bazuar pretendimi ankimor për qasje të kufizuar në dokumente, pasi nuk është dëshmuar se zbulimi i informatave (të kërkuara nga OE ankues) në ndonjë mënyrë e dëmton OE e rekomanduar për kontratë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): “OE ankues po ashtu pretendon se edhe OE ”Cactus” vendosur specifikim teknik, model, brand, brochure për produkte për te cilat ka ofertuar. Pas analizimit të ofertës së OE Cactuss, kemi gjetur se i njëjti ka ofruar specifikacionin Teknik me të gjitha të dhënat e nevojshme siç janë emri i prodhuesit, modeli saktë me të cilin oferton përshtirë edhe specifikacionin Teknik të detajuar të modelit me të cilin oferton. Provë: Oferta e OE Cactuss, Aneksi 1-specifikaiconi Teknik. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore kundrejt OE Cacttues janë të pabazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale OE ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues ndërkaq AK nuk është deklaruar.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative për USHAF” me numër të prokurimit 98400-23-13505-5-5-8 iniciuar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues pasi që Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar me nenin 59 dhe 60 të LPP, duke rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejtë ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të ultë.

Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij në lidhje me papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë janë të papranueshme ngase pretendimi i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifikim teknik, model, brand, brochure për produkte për te cilat ka ofertuar, ndërsa, Paneli Shqyrtues në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë është i bashkangjitur katalogu në të cilin e ka të përfshirë në detaje specifikimin teknik përfshirë edhe emrin e prodhuesit, modelin e saktë me të cilin oferton, etj, si dhe duke marrë parasysh se sipas AK këto specifikime janë konform kërkesave të tyre, kështu që përgjegjësia është e vet AK. Ndërsa në kuptim të nenit 1, 6 dhe 59.4 të LPP, rrjedhimisht, paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e njëjtë por ndaj OE Cactus, Paneli konsideron se me të drejtë eksperti shqyrtues ka gjetur se i njëjti ka ofruar specifikacionin Teknik me të gjitha të dhënat e

nevojshme siç janë emri i prodhuesit, modeli saktë me të cilin oferton përshtirë edhe specifikacionin Teknik të detajuar të modelit me të cilin oferton, Andaj, edhe ky pretendim ankimore sipas ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimore sa i përket qasjes së kufizuar konform nenit 10 dhe 11 të LPP, Paneli Shqyrtues e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues se pretendimi ankimor është i bazuar, por kjo nuk mund ta ndryshojt rezultatin përfundimtar të AK. Andaj, Paneli shqyrtues për shkak se AK nuk ka respektuar në tërësi nenin 10 dhe 11 të LPP, me çrast OE ankues nuk ka pasur mundësi me i parë këto katalogje dhe specifikime teknike, atëherë vendos që të aprovoj si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues, ndërsa të lë në fuqi vendimin për dhënie të AK.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik - shëndeti i qytetarëve.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ**
- **OE - ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: